



Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës  
Savez Sportsko Rekreativnih Ribolovaca Kosova  
Kosovo Federation of Sports Recreational Fishermen

**RREGULLORE NR. 02 / 2024 MBI PUNËN E BORDIT TË FEDERATËS SË  
PESHKATARVE SPORTIV REKREAIV TË TË KOSOVËS**

Prishtinë korrik 2024

Në përputhje me nenin 19 të Statutit të **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës**, Bordi i FPSRK-së me datë ..... PROPOZOJ ketë:

**R R E G U L L O R E N**  
**MBI PUNËN E BORDIT TË KUVENDIT TË FEDERATËS SË**  
**PESHKATARVE SPORTIV REKREAIV TË KOSOVËS**

**Neni 1 – Dispozitat Themelore**

1. Bordi i FPSRK-së është organi më i lartë Ekzekutiv e **Federates e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës**.
2. Kryetarin dhe pesë anëtarët e Bordit të FPSRK-së - i zgjedhë Kuvendi i **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës**, ndërsa Kryetari i Bordit emrrohet në pajtim me Statutin e **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës**.
3. Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi apo dorëheqja e anëtarëve të Bordit të FPSRK-së bëhen në pajtim me Statutin e FPSRK-së dhe aktet tjera normative të FPSRK-së.
4. Për punën dhe funksionimin e vet, Bordi i FPSRK-së i përgjigjet Kuvendit të FPSRK-së.

**Neni 2 - Fushëveprimi**

1. Ka përgjegjësi për kryerjen e punëve dhe detyra tjera të cilat janë në përputhje me këtë statut dhe legjislacionit në fuqi;
2. Konvokon e mbledhjen e Kuvendit dhe propozon rendin e ditës për të;
3. Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera që i miraton Kuvendi.
4. Harton Rregulloren për licencimin e klubeve dhe shoqatave;
5. Propozon për shumën e lartësisë së pagesës së anëtarësisë;
6. Ekzekuton vendimet, konkluzionet dhe politikat e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi;
7. Propozon rregullore tjera të brendshme që nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Federatës;
8. Propozon strukturën organizative të Federatës, duke miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës dhe dergohet per miratim ne Kuvend;
9. Propozon kalendarin e garave dhe dergohet per miratim ne Kuvend;
10. Propozon plan programin e Këshillit Profesional dhe Rregulloren për Punën e Reprezentacioneve të Federatës dhe dergohet per miratim ne Kuvend;
11. Propozon Rregulloren e Garave të Federatës dhe dergohet per miratim ne Kuvend
12. Propozon Rregulloren Disiplinore dhe dërgohet per miratim ne Kuvend;
13. Propozon sistemin e garave për të gjitha kategoritë dhe dërgohet per miratim ne Kuvend;
14. Propozon Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar dhe dërgohet për miratim ne Kuvend;
15. Propozon Kodin Etik të FPRSK-së dhe dergohet për miratim ne Kuvend

16. Bordi mund të kryejë edhe funksione tjera të cilat i delegohen nga Kuvendi, si dhe të gjitha funksionet të cilat shprehimisht me këtë Statut apo me aktet tjera normative të Federatës apo me legjislacionin në fuqi nuk i delegohen Kuvendit të Federatës apo ndonjë organi tjetër kompetent.

#### **Neni 4 Delegimi i kompetencave të Bordit**

1. Bordi i FPSRK-së mund të krijojë këshilla dhe komisione ad-hoc, në rast se të njëjtat konsiderohen si të domosdoshme për funksionimin e tij. Në rast të tillë, Bordi do t'ua përcaktojë të atyre detyrat, kohëgjatësinë, kompetencat dhe fushëveprimtarinë funksionale.
2. Puna në trupa të tilla punuese do të zhvillohet në analogji me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Bordi i FPSRK-së mund t'ia delegojë kryerjen e një detyre edhe një personi të vetëm.
4. Bordi i FPSRK-së mund t'i autorizojë punonjësit administrativ apo profesional të FPSRK-së që të kryejë ndonjë punë që është nën kompetencën e Bordit të FPSRK-së.

#### **Neni 5 Sekretari i FPSRK-së**

1. Udhëheq dhe është përgjegjës për punën e zyrës së Federatës;
2. Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Bordi Ekzekutivt dhe trupave punuese;
3. Përgatit materialet për mbledhjet e Kuvendit dhe Bordit Ekzekutiv, nën mbikëqyrjen e Kryetarit;
4. Kryen detyra tjera me të cilat e ngarkon Bordi Ekzekutiv; 5. I propozon Bordit Ekzekutiv formimin e trupave/komisioneve punuese me aprosim te Kuvendit.
6. Realizon bashkëpunimin me Federatat dhe organizatat e tjera sportive jashtë Kosovës;
7. Realizon bashkëpunimin me KOK-un, MKRS-në, Departamentin e Sporteve të Kosovës dhe organizatat e tjera sportive të Kosovës;
8. Mbanë kontakte me mjetet e informimit;
9. Ndihmon në hartimin e rregulloreve dhe akteve normative që miratohen nga Kuvendi.
10. I propozon Bordit Ekzekutiv profilin e bashkëpunëtorëve administrative-profesional;
11. Interpreton aktet normative të Federatës që miratohen nga Kuvendi.
12. Siguron përkrahje profesionale dhe administrative për Kuvendin, Bordin Ekzekutiv dhe organet tjera të Federatës, sipas nevojës.

#### **Neni 6 Punimet e Bordit të FRK-së**

1. Anëtarët e Bordit të FPSRK-së për mbledhjet e Bordit njoftohen përmes ftesave fizike dhe/ose elektronike (e-mail, telefon), të cilat dërgohen shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes, por mundet ne raste te ndryshme edhe së paku një ditë para mbajtjes së

- mbledhjes. Anëtarët e Bordit të FSPRK-së duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.
2. Rendi i ditës për mbledhjet e Bordit të FSPRK-së dhe ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të FSPRK-së, duhet t'i dërgohen të gjithë anëtarëve të të njëjtit së bashku me ftesën për mbledhjen e radhës.
  3. Të gjithë anëtarët e Bordit të FSPRK-së kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen vijuese. Kjo kërkesë duhet t'i parashtronhet me shkrim Presidentit apo Sekretarit, në formë fizike apo elektronike.
  4. Mbledhjet e Bordit të FSPRK-së i kryeson Kryetari tij. Në mungesë të tij, me autorizim paraprak me shkrim, mbledhjet e Bordit mund t'i kryesojnë nën/Kryetari i FSPRK-së apo ndonjë anëtarë Bordit të FSPRK-së.
  5. Në mbledhjet e Bordit të FSPRK-së, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtarë ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 dy) minuta. Kryesuesi i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Bordit të FSPRK-së.
  6. Në rast të mosrespektimit dhe mospërfilljes së paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni, Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia merr fjalën anëtarit.
  7. Për të gjitha mbledhjet e Bordit të FSPRK-së mbahet procesverbal nga Sekretari i FSPRK-së, apo në mungesë të tij nga ndonjëri prej anëtarëve të Bordit apo nga zyrtarët punonjësit e zyrës) që cakton Sekretari për këtë mbledhje me shkrim. Procesverbal duhet t'i përbajë të gjitha vendimet e nxjerra nga Bordi si dhe të gjitha diskutimet relevante në favor apo kundër vendimeve përkatëse.
  8. Procesverbal i mbledhjeve të Bordit mbahet në formë të plotë arkivat e FSPRK-së, ndërsa ekstrakti i të njëjtit i dërgohet të gjithë anëtarëve të Bordit, në pajtim me paragrin 2 të këtij neni.
  9. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit bëhet në mbledhjen e parë vijuese të tij, si pikë e parë e rendit të ditës.

### **Neni 7** **Vendimet e Bordit të FSPRK-së**

1. Vendimet e Bordit të FSPRK-së mund të merren me shumicë votash në njëren nga mënyrat në vijim:
  - a) Në mbledhje të Bordit të FSPRK-së, në të cilën të pranishëm janë së paku shumica e anëtarëve të Bordit të FSPRK-së. Vendimet e Bordit të FSPRK-së do të jenë të vlefshme në rast se për to votojnë shumica e anëtarëve të Bordit të FSPRK-së të pranishëm në mbledhjen në fjalë.
  - b) Përmes deklarimit elektronik të anëtarëve të Bordit të FSPRK-së, me ç'rast vendimet janë të vlefshme vetëm në rast se për miratimin e tyre deklarohen shumica e të gjithë anëtarëve të Bordit të FSPRK-së. Materialet përcjellëse dhe forma e projektvendimit

- që mëtohet të nxirret përmes formës së përcaktuar në këtë nënparagraf duhet të dërgohen së paku një ditë para afatit të përcaktuar për deklarim elektronik.
- c) Asnjë anëtarë i Bordit nuk mund te abstenon ne votim, por duhet te voton pro apo kundër. Kurse ne rastet kur kemi të bëjmë ne votim te barabartë, vota e presidentit përcakton vendimin definitiv.
2. Propozimet për nxjerrjen e vendimeve sipas formës së përcaktuar në nënparagrafin b) të paragrafit 1 të këtij neni i bën Presidenti i Bordit të FRK-së, ndërsa i administron Sekretari i FPSRK-së.

**Neni 8**  
**Mbledhjet e Bordit**

Sipas dispozitave të kësaj rregulloree përgatiten, caktohen dhe mbahen mbledhjet e Bordit të FPSRK-së dhe realizohen autorizimet dhe obligimet e saj.

**Neni 9**  
**Përbërja e Bordit**

Bordi i FRK-së përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë:

- Kryetari/ja;
- Nenkryetari/ja
- 5 (tre) anëtarë.

**Neni 10**  
**Mandati**

1. Mandati i anëtarëve të Bordit të FPSRK-së zgjatë 4 (dy) vite, me mundësi vazhdimi edhe për 1 (një) ose më shumë mandate.
2. Mandati i anëtarëve të Bordit mund të pushoi edhe para skadimit të mandatit në këto raste:
  - a. dorëheqja e anëtarit të Bordit;
  - b. shkarkimi i/e tij/saj;
  - c. me shpërbërjen e organizatës;
  - d. me vdekje;
  - e. në rastet tjera të parapara me Ligj dhe Statut.
3. Bordi i FPSRK-së mund të nxjerr Vendim mbi fillimin e iniciativës për shkarkim nga anëtarë i Bordit tek organi apo organizata e cila e zgjedh dhe shkarkon anëtarin e Bordit.

4. Ditën që nxirret një Vendim i tillë, anëtari i Bordit të FPSRK-së nuk mund të marr pjesë në mbledhjet e Bordit të FPSRK-së .

**Neni 11**  
**Mbledhjet e Bordit të FPSRK-së**

1. Bordi i FRK-së në mbledhjet e veta nxjerr Vendime, Konkluzione, Qëndrime, jep mendime, nisë iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme.
2. Mbledhjet e Bordit të FPSRK-së mbahen sipas nevojës, por më së paku njëherë në muaj.
3. Në mbledhjet e Bordit mbahet procesverbali apo edhe mund të incizohet. Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai. Procesverbalin e nënshkruan Procesmbajtësi dhe Kryetari.

**Neni 12**  
**Përgaditja Dhe Thirrja E Mbledhjeve Të Bordit Të FPSRK-së**

1. Përgatitjen e mbledhjeve të Bordit e organizon Kryetari i Bordit. Në përgatitjen e mbledhjes së Bordit janë të obliguar të marrin pjesë edhe Nënkyetari, Sekretari i Përgjithshëm si dhe persona tjerë që i fton kryetari.
2. Propozimin e Rendit të ditës për mbledhjet e Bordit e përcakton Kryetari, sipas iniciativës së vet apo sipas propozimit të anëtarëve tjerë të Bordit.
3. Materiali për mbledhje të Bordit të FPSRK-së përmban Propozim Vendime, Konkluzione dhe masa të tjera me arsyetimin e duhur, si dhe Procesverbali nga mbledhja e kaluar e Bordit. Materiali për mbledhje dërgohet së bashku me ftesë për mbledhje.
4. Mbledhjen e Bordit e thërret Kryetari i Bordit. Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjen e thërret Nënkyetari apo njëri nga anëtarët që e autorizon Kryetari.
5. Për mbledhje të Bordit ftohen gjithmonë të gjithë anëtarët. Ftesa për mbledhje bëhet në formën me shkrim, së paku 3 (tre) ditë para mbajtjes së mbledhjes. Ftesa mund të dërgohet edhe në mënyrë elektronike me kusht që anëtarët ta konfirmoi pranimin e saj.
6. Prania në mbledhje është e obligueshme. Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, ai ka për obligim që ta njoftoi Kryetarin paraprakisht.

**Neni 13**  
**Puna në mbledhjet e Bordit**

1. Bordi i FPSRK-së punon dhe vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kryesisë.

2. Me punën e Kryesisë udhëheqë Kryetari. Në rast të mungesës së Kryetarit, mbledhjen e udhëheq Nënkyetari apo Sekretari i Përgjithshëm apo njëri prej anëtarëve. Në raste të jashtëzakonshme, mbledhjen mund ta udhëheq personi i autorizuar.
3. Kryetari udhëheqë me punën e Bordit, iu jep dhe merr fjalën, propozon rendin e ditës, kujdeset për rendin dhe zbatimin e Rregullores së punës, tërheq vërejtjen për tejkalimin e kohës së diskutimit dhe daljes nga rendi i ditës.
4. Për secilën pike të rendit të ditës bëhet shqyrtim i veçantë dhe sipas radhitjes së miratuar.
5. Bordi i FPSRK-së mund të vendos sipas propozimit të Kryetarit që koha e diskutimit të kufizohet. Anëtari i Bordit ka të drejtë në replikë, nëse drejtpërdrejtë është përmendur apo në një mënyrë tjeter është kundërshtuar qëndrimi i tij, por ajo replikë nuk mund të jetë më e gjatë se 5 (pesë) minuta.
6. Çdo Vendim i Bordit të FPSRK-së e obligon Kryetarin për ndërmarrjen e masave për zbatimin e tij.
7. Bordi i FPSRK-së në mbledhjet e veta veçanërisht i kushton kujdes zbatimit të vendimeve të veta, konkluzioneve dhe masave të tjera që i ka nxjerrë në mbledhjen e më parme.

### **Neni 14** **Vendimet dhe Votimi**

Vendimet e Bordit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Bordit. Para votimit për çdo pikë të rendit të ditës mund të kërkohet që të konstatohet kuorumi. Votimi bëhet në mënyrë të hapur me ngritjen e dorës. Në raste të veçanta, Bordi i FPSRK-së mund të nxjerr Vendim për votim të fshehtë.

### **Neni 15** **Dispozitat përfundimtare**

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës** dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së.



Kryetar i Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës